

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Merr fund Tirana International Film Festival (FOTOT)
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/merr-fund-tirana-international-film-festival-fotot-i588863
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:44:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	71d780a91b6e09107f7bfb36aedf980e5e4c9886b7b1fac92322f8bdd13e65da
TEKSTI	2ff776747b3c5bbbdd6da1bee60c66a3bbba6dd2fb48f68b6ed1fb4d798d90e7
PAMJA	786d6dcc54ee7233b2df7bd84830200cfefcdcf725fbd26036fab222721799e9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50177cd77f4b41db1710e625cfa53efa58c6d26ed8e457a9337769a8a0793bf3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/50177cd77f4b41db1710e625cfa53efa58c6d26ed8e457a9337769a8a0793bf3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie SHBA terhiqet nga Iraku, forcat amerikane largohen plotesisht nga vendiNgre siparin ekspozita e piktorit Pellumb Pucit ne kalane e GjurokastresNatta rritet ndersa bise fundit

Merr fund Tirana International Film Festival (FOTOT)



28 Shtator 2026, 11:41Kulturë TEMA



Nata finale e Tirana International Film Festival (TIFF) u mbyll me shpalljen e fituesve të edicionit të këtij viti, duke kurorëzuar filmat dhe autorët që spikatën për gjuhën e tyre artistike, trajtimin e temave bashkëkohore dhe qasjet e veçanta kinematografike.

Çmimi për Regjinë më të Mirë shkoi për Eimi Imanishi për filmin "Nomad Shadow", bashkëprodhim i Francës, Spanjës dhe SHBA-së. Juria e vlerësoi si një debutim të jashtëzakonshëm regjisorial, që e shndërron zhvendosjen dhe përkatësinë në një dramë intime njerëzore. Filmi spikat për gjuhën e tij pamore dhe mënyrën e përmbajtur e të ndjeshme të trajtimit të personazheve.

Çmimi Best PerspecTIFF, një nga vlerësimet kryesore të festivalit, iu dha filmit "Lust" me regji të Ralitza Petrova, një bashkëprodhim mes Bullgarisë, Danimarkës dhe Suedisë, i vitit 2026. Juria vlerësoi portretizimin e kthjellët dhe të zhveshur nga iluzionet të Bullgarisë së sotme, duke e cilësuar filmin si një vepër që kapërcen skemat e dramës sociale dhe shndërrohet në një eksplorim të tjetërsimit, dëshirës dhe trashëgimisë. Në qendër të tij qëndron një personazh kompleks, përmes të cilit ndërthuren dimensionin personal dhe ai shoqëror.

Në kategorinë Best Short Film, çmimi shkoi për "Flesh Impact" të Maggie Gyllenhaal, prodhim amerikan i vitit 2026. Filmi, i cili propozohet për t'u kandiduar në edicionin e 99-te të Academy Awards® 2027, u vlerësua për nivelin e lartë të realizimit dhe qasjen e drejtpërdrejtë e fizikisht të ngarkuar ndaj trupit, si dhe për përdorimin e kontrolluar të imazhit, zërit dhe interpretimit.

Në kategorinë BEST EUROPEAN SHORT FILM, fitoi "Nobody Said Anything" nga Tamara Todorovic, një bashkëprodhim Kroaci, Francë, Serbi e Slloveni, prej 15 minutash. Filmi do të propozohet për t'u kandiduar në Academy Awards® 2027, pasi u vlerësua për: ndërtimin mjeshtëror të tensionit dhe portretizimin e hollë të mosbesimit dhe humbjes së përshkallëzuar të solidaritetit. I saktë, shqetësues dhe thellësisht prekës, "Nobody Said Anything" tregon se sa shpejt përgjegjësia kolektive mund t'ia lërë vendin heshtjes.

Çmimi Best Live Action Short Film iu dha "And If Thuy Didn't Exist" me regji të Carlo Francisco Manatad, një bashkëprodhim mes Francës, Indonezisë dhe Filipineve. Juria vlerësoi portretizimin e ndjeshëm dhe mënyrën se si filmi ndërthur emocionin me momente humori të hollë, duke i dhënë peshë edhe asaj që mbetet e pathënë.

Në kategorinë Best Documentary, fitues u shpall “With Sand in Our Eyes” me regji të Kiki Ho, nga Holanda. Dokumentari u vlerësua për guximin për t’u dhënë hapësirë betejave të padukshme dhe për mënyrën e butë e të dhembshur me të cilën trajton dhimbjen, vetminë dhe humbjen.

Çmimi Best Animation Short Film shkoi për “Once in a Body” të María Cristina Pérez, prodhim kolumbiano-amerikan. Filmi u vlerësua për mënyrën se si e shndërron trupin në një hapësirë të gjallë kujtese, ndryshimi dhe imagjinate, përmes një gjuhe të veçantë pamore.

Ndërsa Best Short Documentary iu dha “Anatomy of a Portrait” me regji të Juan Felipe León, nga Kolumbia. Juria e vlerësoi filmin për mënyrën se si trajton me respekt, dinjitet dhe bukuri temën e vdekjes, një prej përvojave më domethënëse të jetës.

Në kategorinë Best Video Art & Experimental, çmimi shkoi për “I Think You Should Be Here”, me regji të Anna-Marija Adomaitytė dhe Élie Grappe, prodhim franko-zviceran. Filmi u vlerësua për mënyrën se si trajton fenomenin e banalitetit në rrjet, me një qasje të kthjellët dhe vëzhguese.

Çmimi Best Balkan Short Film iu dha “Desert, She” të Ioanna Digenaki, nga Greqia. Juria veçoi gjuhën e veçantë kinematografike të filmit, ndjesinë e fuqishme të nxehtësisë së jetës së përditshme dhe portretizimin e një brezi që përballet me pasigurinë në një qytet ku uji po shteron.

Në kategorinë Best in Albanian Short Film, fitues u shpall “angel777” me regji të Brilant Pireva, nga Kosova. Filmi u vlerësua për strukturën e freskët dhe origjinale narrative dhe për mënyrën se si trajton një sërë çështjesh që lidhen veçanërisht me realitetin dhe shqetësimet e brezit të ri.

Çmimi Best Student Fiction shkoi për “Silent Voices” të Nadine Misong Jin, një produksion i Koresë së Jugut dhe SHBA-së. Filmi spikati për trajtimin e ndjeshëm dhe autentik të marrëdhënieve familjare dhe emocioneve të pathëna, ndërsa regjia minimaliste i beson fuqisë së imazhit dhe heshtjes për të krijuar një atmosferë intime.

Me shpalljen e këtyre çmimeve, TIFF përmbylli edicionin e tij me një panoramë të larmishme të kinemasë bashkëkohore, një numër të lartë premierash botërore e kombëtare, duke sjellë në vëmendje autorë të rinj dhe krijues të konsoliduar, si dhe histori që lëvizin mes përvojës personale, realitetit social, kujtesës, identitetit dhe sfidave të kohës. A.K./Tema

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ngre siparin ekspozita e piktorit Pëllumb Pucit në kalanë e Gjirokastrës

09:34 Kulturë

Faik Islami, një jetë mes fjalës, vuajtjes dhe së vërtetës

21:46 Kulturë

Duke filluar nga 3 tetori Festivali Ndërkombëtar i Kërcimit kthehet në Tiranë

17:50 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.